R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**
**KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT**

# Vendim

**Nr. 12 Date 27.04. 2017**

**"Për miratim të Lejes së Përdorimit të Ujit për prodhim të energjisë elektrike, nëpërmjet ndërtimit të HEC "Pambad" në Përroin e Zallit të Hotit, Lumi Mat, në Njësinë Administrative Burrel, Bashkia Mat, Qarku Dibër, Subjektit " S.P.E.Energji"shpk".**

- **Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 te** ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore", nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015,"Per miratimin e rregullave dhe proçedurave të ndërtimit të kapiciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni"(i ndryshuar) si dhe miratimit paraprak ***Nr.3356/4 datë 24.11.2016*** të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, me propozim te A.B.U. Mat,
**Këshilli i Basenit Ujor Mat,**

## Vendosi:

1- Miratimin **të Lejes së Përdorimit të Ujit për prodhim të energjise elektrike,** subjektit subjektit" **S.P.E.Energji " shpk,** me Administrator Z. Valentin Kaçorri , me këto të dhëna:

**HEC "PAMBAD"**

-Prurja mesatare : Q= 0.845m3/sek,
-Prurja llogarites: Q= 1.816 m3/sek,
-Prurja ekologjike: Q= 0.21m3/sek,
-Prurje per perdorime te tjera: __________m3
-Energjia e planifikuar vjetore: 2 935 313 kwh/vit,
-Fuqia 1015kw, _______ore pune/vit

| | | | |
|---|---|---|---|
| -Kuota e vepres se marrjes | Z-212.5 m.n.d | X-44 09 818.4 | Y-46 12 542 |
| -Kuata e godines se centralit: | Z-129 m.n.d | X- 44 09 468.3 | Y- 46 14 873.5 |

**2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit te vaditjes,i furnizimit me uje te popullates etjere nga perdorimi i ujit per energji elektrike.**

**3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.**

**PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT**
**Ast NIKOLLA**

**KRYETARI I K.B.U. MAT**
**Eduard NDRECA**